

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shukri Sylejmani, kryetar, Nazmije Ibrahimimi dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve S.B., nga komuna e Deçanit, V.P. dhe M.M., që të dy nga Bujanovci, të cilët i përfaqëson Z.N., avokat nga Peja, kundër së paditurës K.S. "S" në Prishtinë, për dëmshpërblim, lidhur me revizionin e paditëses S.B. dhe revizionit të së paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.3569/2012, datë 08.12.2014, në seancën e mbajtur më 11.05.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Hidhet poshtë si i palejueshëm revizioni i paditëses S.B., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.3569/2012, datë 08.12.2014.

PJESËRISHT pranohet si i bazuar revizioni i të paditurës dhe NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.3569/2012, datë 08.12.2014, dhe aktgjykimi i Gjykatës Komunale Deçan, C.nr.219/2011, datë 05.03.2012, përkitazi me dëmshpërblimin e aprovuar për dhimbjet fizike dhe frikën e përjetuar të paditëses S.B., së cilës, në emër të dhimbjeve fizike, i pranohet shuma prej 1.200 € dhe, në emër të frikës së pësuar, po ashtu, shuma prej 1.200 €, ndërsa përtej këtyre shumave kërkesëpadia e paditëses refuzohet si e pabazuar. Këto aktgjykime ndryshohen edhe përkitazi me datën e fillimit të pagesës së kamatës, e cila duhet të jetë 05.03.2012, kur është dhënë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

Përkitazi me kompensimin e aprovuar në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe ushqimit të përforcuar për paditësen S., si dhe për kompensimin e aprovuar për paditësit V.P dhe M.M., si në dispozitiv të aktgjykimit të Gjykatës Komunale Deçan, C.nr.219/2011, datë 05.03.2012, revizioni i të paditurës refuzohet si i pabazuar.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Komunale Deçan, C.nr.219/2011, datë 05.03.2012, është detyruar e paditura që, në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut në datën 02.01.2010, t'u paguajë: paditëses S., në emër të dhimbjeve fizike - shumën prej 1.700 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 5% - shumën prej 1.200 €, në emër të frikës së pësuar - shumën prej 500 € dhe, në emër të ushqimit të përforcuar - shumën prej 100 €; paditëses M.M., në emër të dhimbjeve fizike - shumën prej 200 € dhe në emër të frikës së pësuar - shumën prej 400 € dhe paditësit V.P., në emër të dhimbjeve fizike - shumën prej 650 €, dhe në emër të frikës së pësuar - shumën prej 400 €, të gjitha me kamatë sipas normës prej 3,5%, që paguajnë bankat afariste në Kosovë për depozitat e kursimit mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 21.09.2010 gjer në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 1.274 €. Përtej shumave të aprovuara, kërkesëpadia e paditësve është refuzuar si e pabazuar.

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.3569/2012, datë 08.12.2014, është vërtetuar aktgjykimi i lartpërmendur i gjykatës së shkallës së parë sa u përket shumave të aprovuara për paditësit, me përjashtim të shumës së aprovuar për paditësen S., në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, lidhur me të cilën aktgjykimi i shkallës së parë është ndryshuar, ashtu që asaj i është pranuar shuma prej 500 €, ndërsa pjesa tjetër, përtej kësaj shume, i është refuzuar si e pabazuar. Me të njëjtin aktgjykim është ndryshuar aktgjykimi i shkallës së parë edhe përkitazi me kamatën e aprovuar, ashtu që e paditura është detyruar që shumat e aprovuara t'ua paguajë paditësve me kamatë të cilën e paguajnë bankat komerciale në Kosovë për mjetet e depozituara mbi 1 vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 21.09.2010, deri në pagesën përfundimtare të borxhit. Edhe vendimi për shpenzimet procedurale është ndryshuar si në pikën III. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që e paditura është detyruar që paditësve t'ua paguajë shumën prej 500 €, ndërsa pjesa tjetër, në emër të shpenzimeve procedurale në shumën prej 774 €, është refuzuar si e pabazuar. Pjesët III dhe IV të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë kanë mbetur të pashqyrtuara.

Kundër aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësja S. B. dhe e paditura me kohë kanë paraqitur revizion, e para kundrejt pjesës së refuzuar të kërkesëpadisë dhe e dyta ndaj pjesës së aprovuar të saj, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, ashtu që paditësja S. ka propozuar që aktgjykimi i goditur me revizion dhe ai i shkallës së parë të ndryshohen dhe përkritazi me kompensimin për zvogëlim të aktivitetit jetësor aktgjykimi i shkallës së parë të lihet në fuqi, kurse e paditura ka propozuar që të dy aktgjyqimet të prishen dhe lënda të kthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK, shqyrtoi lejueshmërinë e paraqitjes së revizionit të paditëses S. dhe aktgjykimin e goditur me revizion, dhe konstatoi:

Revizioni i paditëses S. është i palejueshëm, ndërsa revizioni i të paditurës është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në datën 02.01.2010, në rrugën “Tirana” në Gjakovë është shkaktuar një aksident trafiku, me pjesëmarrës: veturën e markës “Golf” me targa ..., të cilën e drejtonte B. (S.) S., nga Gjakova, dhe veturën e markës “...” me targa ..., të cilën e drejtonte paditësja S. dhe në të cilën ndodheshin, si bashkudhëtarë, edhe paditësit M. M. dhe V. P., Ky aksident ka ndodhur për fajin e drejtuesit të automjetit të parë, i siguruar tek e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë së paditësve nuk është kontestuese. Nga ekspertiza mjekësore e dr. I.K., ortoped traumatolog dhe dr. M.B., neuropsikiatër, rezulton se paditësja S., e lindur në vitin 1976, në këtë aksident ka pësuar kontuzion të kokës dhe qafës, tronditje truri, kontuzion të krahut të djathtë dhe shqetësime nervore, të cilat, sipas këtyre ekspertëve, kualifikohen si lëndime të rënda trupore. Ndërkaq, paditësja M. ka pësuar kontuzion regional torakal, kurse paditësi V. ka pësuar plagë prerëse të kërcirit të majtë. Lëndimet e paditësve V. e M. kualifikohen si lëndime të lehta trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve, paditësja S. ka pësuar dhimbje fizike dhe frikë me intensitet dhe kohëzgjatje të ndryshme dhe zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 5%, i cili manifestohet me dhimbje koke të kohëpaskohshme, ushtimë në vesh, simptome këto që paraqiten sidomos gjatë qëndrimit të gjatë në diell, me rastin e ngjitjes në lartësi dhe zbritjes, qëndrimit një kohë të gjatë me kokën ulur ose qëndrimit në të gjatë në pozicioni leximi, gjatë shikimit në kompjuter dhe me rastin e ndërrimit të temperaturave. Paditësja S. ka pasur nevojë

edhe për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 2 javësh. Paditësit M. dhe V. kanë pësuar dhimbje fizike dhe frikë me intensitetit të mesëm dhe të ulët.

Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar kësisoj, gjykata e shkallës së parë, duke gjetur se e paditura është përgjegjës për kompensimin e dëmit ndaj paditësve, sipas vlerësimit të saj të lirë dhe, duke u bazuar edhe në nenin 200 të LMD, i ka aprovuar shumat e precizuara në hollësi në dispozitiv të aktgjykimit të saj, ndërsa përtej shumës së aprovuar, kërkesëpadinë e paditësve e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së dytë, duke vepruar në procedurën ankimore, për të njëjtat shkaqe dhe arsye të dhëna nga gjykata e shkallës së parë, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë, kurse i njëjti aktgjykim, në pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë, ka mbetur i pandryshuar, meqë ndaj saj nuk ka pasur ankesë. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ndryshuar vetëm përkitazi me kompensimin e aprovuar për paditësen S., në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, ashtu që lidhur me këtë formë të dëmit jo material i është pranuar shuma prej 500 € ashtu sikurse edhe lidhur me kamatën e caktuar, ashtu që paditësve, mbi shumat e aprovuara kamata u është pranuar në tërësi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës e pranoi në tërësi qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta lidhur me pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë së paditësve për dëmshpërblim në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe ushqimit të përforcuar - për paditësen S., si dhe përkitazi me dëmshpërblimin për paditësit M. dhe V. të aprovuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, pasi që aktgjykimet e goditura, në këtë pjesë, nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Mirëpo, shumat e aprovuara për paditësen S., në emër të kompensimit për dhimbje fizike dhe frikë, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, janë të larta dhe në shpërputhje me qëllimin shoqëror, për të cilin parashikohet kompensimi i këtyre formave të dëmit, kështu që, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, nisur nga kriteret e parashikuara nga neni 200 i LMD, këto shuma nuk janë reale dhe, si të tilla, paraqesin qëllime fitimprurëse për paditësen S., andaj u desh që në këtë pjesë të dy aktgjykimet të ndryshohen dhe paditëses t'i caktohen shuma reale, të cilat, në

fakt, paraqesin sadisfaksion real për paditësen kundrejt dëmit të pësuar në formë të dhimbjeve fizike, dhe frikës së pësuar.

Mirëpo, sa i përket shumës së pranuar nga gjykata e shkallës së dytë, paditëses S., në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor në shumën prej 500€ për 5% të këtij zvogëlimi, si dhe shumës së pranuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë për kompensim dëmi ndaj paditësve M. dhe V., si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, duke pasur parasysh standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës dhe në praktikën gjyqësore të deritanishme, këto shuma janë reale dhe, si të tilla, nuk paraqesin qëllime fitimprurëse për paditësit, prandaj revizioni i të paditurës në këtë drejtim u refuzua si i pabazuar. Në këtë kontekst, me rëndësi vendimtare ishte se paditësit M. e V. kishin pësuar lëndime të lehta trupore, për të cilat kompensimi i aprovuar është real.

Data e fillimit të llogaritjes së kamatës së aprovuar u ndryshua si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase në këtë rast vlerësimi i dëmit jo material nga ana e gjykatës së shkallës së parë është bërë me rastin e vendimmarrjes e jo edhe më parë, kur nuk është ditur se cila është përmasa e dëmit që e paditura duhet t'ua kompensojë paditësve.

Revizioni i paditëses S. u hodh poshtë si i palejueshëm, pasi ajo e ka goditur aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë vetëm ndaj pjesës në të cilën u ndryshua kompensimi në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor nga 1.200 € në 500 €, sepse kjo shumë, si vlerë e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit, nuk e tejkalon shumën prej 3.000 €, që kërkohet si kusht për paraqitje të revizionit - në nenin 211.2 të LPK.

Për arsyet e lartpërmendura, me hedhjen poshtë si të palejueshëm të revizionit të paditëses S. Dhe me aprovimin e pjesshëm të revizionit të së paditurës, në kuptim të nenit 221 dhe 224.1 të LPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Rev.nr.115/2016 datë 11.05.2016

Kryetar i kolegjit,
Shukri Sylejmani

